



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga një parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 73-të, të mbajtur më 18.08.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-6104/1 i datës 20.06.2022, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Denoncimi të dorëzohet në Ministrinë e punëve të brendshme të RMV-së dhe në Drejtorinë e sigurimit të informacionit të fshehtë të RMV-së.

Lënda me numër 12-6104 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-6104/1 të datës 20.06.2022 është formuar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur. Në denoncim theksohet se eprori /// në Ministrinë e Punëve të Brendshme të RMV-së, u mundësoi dy zyrtarëve - ///, /// dhe /// të menaxhojnë dhe punojnë me informacione të klasifikuara për një ditore, disa prej të cilave me gradën "rreptësishtë konfidenciale", pa poseduar certifikatën përkatëse të sigurisë. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Nga mbikëqyrja në përmbajtjen e denoncimit dhe provave të dorëzuara , KSHPK-ja vlerësoi se lënda nuk elemente për veprim kompetent. Autoritetet kompetente për trajtimin e denoncimit janë Ministria e Punëve të Brendshme e RMV-së dhe Drejtoria për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar të RMV-së, prandaj KSHPK-ja vendosi t'ua përcjellë denoncimin për veprime kompetente këtyre autoriteteve.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: S. P. D.

КОМИСИОНИ СХТЕТЁРОРЁ
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
КРЈЕТАРЕ,
Biljana Ivanovska

